



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E OFRIMIT TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL BERAT
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Berat, më / / 2024.

PROCESVERBAL - TIPI I KONTRATËS-SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

Objekti: “Studim-Projektim te Poliklinikes Qendrore te Spitalit Rajonal Berat”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71221000-3 –
Sherbim per Projektim Ndertesash.**

Fondi limit: 5,634,705 (pesemilioneqjashteqindetridhjeteekatermijeeshateqindepese) lekë pa TVSH, vene ne dispozicion nga te ardhurat e vet institucionit. Eshte perlllogaritur nga Specialist i Fushes me shkresat Nr. 5275 Prot., date 24.11.2023, Nr. 5275/1 Prot., date 24.11.2023.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Spitali Rajonal Berat” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*
b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Ne vleren 2% te fondit limit te perlllogaritur vlere eshte **112,694.1** (njqindedybedhjetemijeegjashteqindenentedhjeteekaterpikenje).*

c. *Formularin e Ofertes sipas shtojces 1 dhe shtojces 2.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 ”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike*

ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet te kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

Shënim:

Operatorët ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi, në përgatitjen e ofertës së tyre duhet të kenë parasysh përcaktimet e VKM-së Nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” në lidhje me vlerat minimale dhe maksimale, të lejuara, të projektimit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe si dhe ne Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, te ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 49 dhe 77, pika 3, e LPP, , nenit 54 dhe nenin 43 pika 2/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate.

Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e xhirros vjetore eshte bere bazuarne nenin 29 ne ligjin nr.8438, date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, Udhezimit te Ministrit te Financave nr. 5, date 30.02.2006, ”Per tatimet mbi te ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kerkesave te ligjit Nr. 25/2018 ”Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nën 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.8438, date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, Udhezimit të Ministrit të Financave nr.5, date 30.01.2006, “Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar si dhe kerkesave te ligjit nr 25/2018 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar neninin 29 te ligjit n3.8438, date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat tatimore: ” *Cdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, duke paraqitur ne te njejten kohe bilancin kontabel se bashku me anekset e tij si dhe cdo te dhene te percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji.*

2.2.3. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2023, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij ,(Sipas ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatori ekonomik lëshuar nga QKB). (Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit).

Shënim: *Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nën 43, nën 41, pika 5/c, të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar dhe bazohet në kërkesat specifike të Ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” I ndryshuar, nën 3.1/a,b,c dhe nën 40, në ligjin nr131.2015 “Per QKB”I ndryshuar si edhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” I ndryshuar.

Megjithatë operatorët ekonomikë kanë detyrim të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, kontratën e shërbimit, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe , si dhe nenit 41, pika 3, neni 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben autoritetit kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zoterojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projektim të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016*”, me kategoritë si më poshtë:

PROJEKTUES ARKITEKT

a- Projektim arkitektonik për objekte civile-industriale-turistike-vepra arti në infrastrukturë.

b-3 Objekte spitalore;

PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a-Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

PROJEKTUES INSTALATOR

a- Projektim të instalimeve hidrosanitare.

b- Projektim të instalimeve termoteknike – ventilimi - kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike-telefonike-citofoni-sistem alarmi-televiziv etj. për objekte civile e industriale.

f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.

g- Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndertesa.

h- Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, etj.)

j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale.

PROJEKTUES GJEODET

a- Rivelime inxhinierike.

b- Rilevime inxhinierike kadastrale

STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK

a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5 kate.

b) Studim/vleresim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrushmeri te ulet.

STUDIM TE SISMOLOGJISE INXHINIERIKE (vetem per shoqeri/subjekte juridike)

b) Studim/vleresime gjeologo-sizmike per trojet ku ndertohen objektet civile, sociale e kulturore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në dokumentacionin teknik të dosjes së projektit të zbatimit të objektit të prokurimit si dhe në VKM nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Pikat e mesiperme jane vendosur ne baze te punimeve te pritshme te parashikuara qe do te kryen ne objektin e perfshire ne kete studim projektim.

Autoriteti Kontraktor kerkon kete kriter per arsytet se pershtaten me tipologjine e studim- projektiveve per rikonstruksionin e objektit tejet te amortizuar.

2.3.3 Ofertuesi ekonomik (per projektuesin) duhet te kete personelin kryesor, Drejtues Teknik te perfshire ne Licensen e shoqerise, vertetuar me kontrata pune te vlefshme, diplomat, Licencat profesionale per projektim, CV si dhe te jene ne Listepagesat te pakten Muajin e Fundit Nga data e hapjes se procedures sipas legjislacionit në fuqi si vijon:

- 1 (nje) Arkitekt
- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi (civil, konstruktor)
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet.

Shënim: Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne ligjin 8402, date 10.09.1998 ”Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Vendosja e këtij kriteri për stafin teknik është bërë në përputhje me dokumentacionin teknik, termat e referencës dhe natyrën e shërbimeve të kërkuara.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar staf mbeshtetes, vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome dhe/ose deshmi kualifikimi (te vlefshme), te cilet duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise te pakten Muajin e Fundit Nga data e hapjes se procedures , si me poshte:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi, profili Strukturist
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog me orientim gjeofizik
- 1 (nje) Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh

- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet (Topograf)
- 1 (nje) Auditues energjie e Certifikuar nga Agjencia per Eficencen e Energjise per te kryer auditime ne ndertesa dhe Instalime Industriale.

Shënim: Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne ligjin 8402, date 10.09.1998 ”Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Vendosja e këtij kriteri për stafin teknik është bërë në përputhje me dokumentacionin teknik, termat e referencës dhe natyrën e shërbimeve të kërkuara.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet te disponoje punonjes te specializuar/ te kualifikuar, si me poshte:

1 (nje) punonjes i pajisur me certifikate si "Ekspert Privat Zjarrfikes" ne perputhje me klauzolat e ligjit nr.152/2015 date 21.12.2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin" shoqeruar me kontrate individuale pune te vlefshme, Diplome/certifikate si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise te pakten Muajin e Fundit Nga data e hapjes se procedures .

Shënim: Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 39, pika 6/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne ligjin 8402, date 10.09.1998 ”Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar, ligjin nr.152/2015 date 21.12.2015 ” Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin”. Eksperti zjarrfikes eshte i nevojshem per te arritur synimin, pasi referuar ligjit nr. 152/2015 ” Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin”, roli i ekspertit zjarrfikes eshte ne perpjestim me natyren e kontrates.

2.4 Kerkesa te tjera te vecanta per kualifikim:

2.4.1 Certifikata qe duhet te kete operatori ekonomik projektues:

- Shoqeria duhet te paraqese certifikate per sherbime ekspertize dhe/ose profesionale te mbrojtjes civile, Kodi I.2.A.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ane te ketij kriteri kerkohej qe operatoret ekonomike te deshmojne qe per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t’u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

2.4.2. Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera pajisjet e mëposhtme:

- Pajisje Total station cope 1 në pronesi ose me qera
- Pajisje GPS cope 1 në pronesi ose me qera

Per pajisjet duhet te paraqese fature tatimore te shitblerjes ose kontrate shitblerje ose kontrate qeraje te noterizuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 41, pika 4/ ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane ne dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike per te permbushur kontraten, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit. Paisjet kerkohen per te rakorduar dhe pozicionuar vendndodhjen si dhe volumetrine e objektit sipas formatit kadastral dhe referuar bazes gjeodezike.

2.4.3 Operatori ekonomik projektues duhet te paraqese me ane te nje deklarate listen e personelit kryesor te nevojshem qe do te realizoje objektin e kontrates si dhe CV te shoqerise per punet e realizuara gjate aktivitetit te saj.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kanë ne dispozicion punonjesit dhe pune te ngjashme bindese për të përmbushur kontratën, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit.

Shenim për operatoret ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 9 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret, specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit, termat e references jane hartuar dhe argumentuar nga Specialisti i fushes dhe te miratuara me Proces verbalin Nr. 568 Prot. date 31.01.2024.

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen: DETYRA E PROJEKTIMIT do te jete pjese e dokumentacionit qe do te ngarkohet ne SPE per kete procedure prokurimi.

Afatet e ekzekutimit: 60 (gjashtedhete) dite pas nenshkrimit te kontrates.

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Studim-Projektim te Poliklinikes Qendrore te Spitalit Rajonal Berat”**

Detyrat: Autoriteti Kontraktor Spitali rajonal Berat me fondin **5,634,705**

(pesemilione gjashteqindetridhjetee katerrmijeeshtateqindepese) lekë pa TVSH kerkon te realizoje Studim-Projektim te Poliklinikes Qendrore.

Ky project do te kerkohet te synoje Rikonstruksionin e Poliklinikes sipas detyres se projektimit me Specifikimet teknike te cilat jane hartuar dhe jane te miratuara me shkresen me Nr. 4977 Prot. date 06.11.2023.

DETYRA E PROJEKTIMIT do te jete pjese e dokumentacionit qe do te ngarkohet ne SPE per kete procedure prokurimi.

Qellimi kryesor eshte te perfitohen me realizimin e ketij projekti koncepte bashkekohore dhe vizionare per nje sherbim sa me cilesor per pacientet te cilet marrin konsulta dhe sherbime mjekesore ne kete institucion te rendesise se vecante.

Shpërndarja: DETYRA E PROJEKTIMIT do te jete pjese e dokumentacionit qe do te ngarkohet ne SPE per kete procedure prokurimi.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: AK Spitali Rajonal Berat.

ARGUMENTIMI LIGJOR DHE TEKNIK I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike jane hartuar dhe jane te miratuara me shkresen me Nr. 4977 Prot. date 06.11.2023.

Bashkengjitur DETYRA E PROJEKTIMIT. DETYRA E PROJEKTIMIT do te jete pjese e dokumentacionit qe do te ngarkohet ne SPE per kete procedure prokurimi.

Specifikimet teknike të mësipërme janë hartuar në bazë të nenit 21, pika 2, nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (në vijim “VKM”),

Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

NJESIA E PROKURIMIT

Aida Doko

Armelin Çili

Gerald Bolani

MIRATOI

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ANI LA KALA